Prospekti i Fondit të Investimit

“ALBSIG STANDARD”

www.albsiginvest.al

Emërtimi i Fondit: Fondi i Investimit Albsig Standard" (në vijim "Fondi")

Forma Ligjore: Fond Investimi-Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur- Sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike e veçantë e krijuar në Republikën e Shqipërisë bazuar në Ligjin. 56/2020, "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive"(në vijim "Ligji"

Shoqëria Administruese: ALBSIG INVEST Sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (në vijim "Shoqëria Administruese") e regjistruar në regjistrin tregtar me, NIPT L92208025J, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HG, Kati 8, Tiranë

Data e Krijimit: Fondi është themeluar më datë 30/12/2019, me licensimin nga AMF, me vendim nr. 255. Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij më 16/01/2020.

Adresa ku mund të aksesohet rregullorja e fondit dhe Pasqyrat Financiare vjetore dhe ndërmjetme: Rregullat e fondit dhe Pasqyrat Financiare vjetore dhe të ndërmjetmet mund të gjendet në adresën Rruga e Barrikadave, Albsig HG, Kati 8, Tiranë. Ky informacion, Prospeki dhe KIID (Informacioni Kryesor mbi Investitorin) janë gjithashtu të disponueshëm në faqen e internetit: ëëë.albsiginvest.al

Data e Publikimit:

Klasat e Kuotave	Kodi Referencë i Fondit	Trajtimi i të ardhurave	Monedha Bazë	Investitorët e synuar
Vetëm një klasë kuote	**F1-B5**	**Të ardhurat janë kumulative**	**Lekë**	**Të gjithë investitorët**

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Fondi i Investimit Albsig Standard (në vijim: "Fondi") është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, e themeluar nga Albsig Invest sh.a. (në vijim: "Shoqëria Administruese"), shoqëri administruese e licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim: "AMF"), për të administruar fonde të pensionit vullnetar dhe sipërmarrje të investimeve kolektive. Shoqëria Administruese e zhvillon aktivitetin e saj në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria Administruese është subjekti juridik qeverisës i Fondit, që e administron dhe e përfaqëson atë në lidhje me palët e treta.

Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, ose fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh, pa personalitet juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënieje kontraktuale, pas licensimit nga AMF, dhe i administruar nga Shoqëria Administruese, me qëllim grumbullimin e aseteve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave të fondit. Fondi investon asetve monetare në asete të përcaktuara në këtë prospekt me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave. Fondet e investimit në krahasim me investimin në mënyrë individuale i ofrojnë investitorëve së pari diversifikimin e investimeve. Mbajtësit e kuotave në varësi të kuotave të tyre kanë të drejtën të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, por dhe të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e tyre pa prishur fitimin e akumuluar deri në atë periudhë.

Ky Prospekt përmban informacionin kryesor në lidhje me Fondin në mënyrë që investitorët potencial të bëjnë vlerësimin nëse toleranca e tyre për rrezik përputhet me rrezikun që përmban Fondi. Çdo investitor duhet të lexojë këtë Prospekt para se të investojë në Fond. Prospekti përmban të gjithë informacionin e nevojshëm që i duhet një investitori për të gjykuar nëse duhet të investojë në Fond. Pjesë thelbësore e Prospektit është Politika e Investimit e cila tregon se në çfarë asetesh do të investojë Fondi dhe llojet e rreziqeve të lidhura me investimin në Fond. Fondi investon kryesisht në obligacione të Republikës së Shqipërisë. Investimet do të kryhen në përputhje me ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloret në zbatim të tij, duke respektuar kufizimet ligjore dhe parimin e diversifikimit të rrezikut.

Investitorët duhet të kontaktojnë dhe të disponojnë një Prospekt vetëm nga persona të autorizuar nga Shoqëria Administruese. Nëse i njëjti informacion është paraqitur nga persona të paautorizuar atëherë ky informacion nuk duhet të përdoret për të ndërmarrë investime në Fond. Shoqëria Administruese ka treguar kujdesin maksimal në paraqitjen sa më të saktë, të ndershme, shteruese dhe kuptimplotë të të gjithë informacionit dhe se nuk ka anashkaluar asnjë informacion të nevojshëm që i duhet një investitori për të gjykuar mbi investimin e tij në Fond.

Prospekti nuk shërben si ftesë për të blerë kuota por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe risqet e lidhura me pjesëmarrjen në Fond.

2. PËRKUFIZIME

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

Asete - letra me vlerë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të anëtarit të Fondit të investimit;

Bursë titujsh - është një bursë titujsh e licensuar nga AMF-ja.

Depozitari - banka e nivelit të dytë, e licensuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe e licensuar nga AMF, për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e Fondit të Investimit;

Diversifikim i portofolit - investim i aseteve në instrumente të ndryshëm për të zvogëluar rrezikun nga investimi;

Duration (kohëzgjatja) - tregues i rrezikut nga normat e interesit i cili tregon ndryshimin e çmimit të një obligacioni (apo e një letre me vlerë me të ardhura fikse) nga ndryshimi i normave të interesit (apo i yield-it në maturim të këtij obligacioni);

Duration (kohëzgjatja) i portofolit - duration (kohëzgjatja) mesatar i ponderuar i obligacion- eve individuale që përbejnë portofolin e investimeve;

FATCA - ligj federal i SHBA-së, i cili u kërkon të gjithë institucioneve financiare të huaja t'i raportojnë Agjencisë së të Ardhurave në SHBA (IRS) informacionin mbi llogaritë financiare të taksa- paguesve amerikanë, ose të entiteteve të huaja në të cilat taksapaguesit amerikanë zotërojnë një përqindje të rëndësishme;

Fitim/humbja nga kapitali - të ardhurat apo humbjet që rezultojnë nga ndryshimi i çmimit të letrës me vlerë;

Fondi i investimeve - sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar me kontratë si grupim i veçantë aktivesh, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit të investimeve.

Instrumente financiare - janë instrumentet financiare të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për tregjet e kapitalit.

Instrumente financiare derivative - janë kontrata midis dy palëve, vlera e së cilave bazohet në një vlerë të një aseti themelor ose të një grupimi asetesh. Asetet themelore të zakonshme janë bonot e thesarit, obligacionet, monedhat etj.

Investitor - personi që ka në zotërim kuotat në një Fond Investimi;

Këshilli i Administrimit - organi i vetëm i Shoqërisë Administruese me funksione administrimi dhe mbikëqyrjeje;

Kthim nga investimi - fitimi që merret nga investimi i aseteve;

Kujdestari- ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare për llogari të klientëve.

Kuotë - pjesa përpjesëtimore e pronësisë në grupin e aseteve të Fondit të Investimit, ku vlera totale e të gjitha kuotave të Fondit të Investimit është e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të këtij fondi;

Kuota akumulimi - kuotat e një Fondi për të cilin të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimet për investitorët vijnë nga akumulimi i vlerës së atyre kuotave;

Ligji për shoqëritë tregtare - është ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtar.

Mbajtës kuotash - çdo person, i cili zotëron kuota ose aksione ose investon kapital në sipërmarrjen e investimeve kolektive, i cili si rrjedhojë përfiton një pjesë përpjesëtimore të pasurisë së sipërmarrjes.

Menaxher i portofolit - personi përgjegjës në Shoqërinë Administruese për administrimin e portofolit;

Njësia akumuluese ose kuota akumuluese - njësia ose kuota në një sipërmarrje të investimeve kolektive, e cila akumulon të ardhurat nëpërmjet kreditimit periodik në kapital, në ndryshim nga shpërndarja;

Ofertë publike - ftesa për të nënshkruar tituj, e cila i drejtohet një numri të papërcaktuar personash, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv;

Persona kyç - persona fizikë, të cilët, sipas dispozitave të legjislacionit ose të dokumenteve të themelimit, përfaqësojnë subjektin ose depozitarin, ose të cilët përcaktojnë në mënyrë efektive politikën e subjektit ose të depozitarit, përfshirë edhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës apo të këshillit të administrimit të këtij subjekti.

Palë e lidhur - është personi fizik ose juridik që është i lidhur me Shoqërinë Administruese apo me shoqërinë e investimit, në rrethana kur personi fizik ose drejtuesi i personit fizik apo juridik është a) anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, i Këshillit të Administrimit ose punonjës i shoqërisë; b) anëtari i Komitetit të Kontrollit të Shoqërisë; c) aksionar ndikues i shoqërisë; ç) bashkëshort ose i afërm deri në shkallën e tretë të lidhjes së gjakut i një anëtari të Këshillit të Mbikëqyrjes, të Këshillit të Administrimit ose të Komitetit të Kontrollit, punonjës i shoqërisë, aksionar ndikues i shoqërisë, kontrollues kryesor i shoqërisë;

Portofol - tërësia e investimeve të kryera me asetet e Fondit;

Prospekt - dokumenti i bërë publik, që përmban informacionin më të rëndësishëm për sipër- marrjen e investimeve kolektive, si politika e investimit, politika e administrimit të rrezikut, etj; Rating (vlerësim) i letrave me vlerë - renditje e letrave me vlerë, e kryer nga Agjencitë Ndërkombëtare të Klasifikimit, sipas nivelit të rrezikut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi;

Rregullat e Fondit - dokumenti kryesor që rregullon marrëdhënien ligjore midis Shoqërisë Administruese dhe mbajtësve të kuotave;

Sipërmarrje investimesh kolektive (SIK) - personi juridik ose bashkimi i posaçëm i aseteve të investitorëve, që funksionon në formën e Fondit të Investimit ose shoqërisë së investimit;

Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur - sipërmarrja e cila në bazë të dokumentit themelues shlyen pjesëmarrjet çdo ditë pune, sipas një çmimi të llogaritur në bazë të vlerës neto të aktiveve për pjesëmarrje të sipërmarrjes, të përcaktuar në përputhje me ligjin.

Sipërmarrje e veçantë - sipërmarrja e investimeve kolektive që nuk është sipërmarrje ombrellë ose nënfond.

Standardi i Përbashkët i Raportimit (CRS) - përbën një kërkesë rregullatore për raportim për Institucionet Financiare të vendosura në juridiksionet pjesëmarrëse dhe ka qëllimin për të shmangur evazionin fiskal.

Shkëmbimi automatik i informacionit për llogaritë financiare (AEIFA) - Ligji nr.4/2020, datë 30/01/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare".

Shoqëri Administruese - shoqëri aksionare, e krijuar sipas ligjit nr.9901/2008, i ndryshuar, dhe e licensuar nga AMF, për të administruar një ose disa Fonde pensioni dhe/ose sipërmarrje të investimeve kolektive;

Shpërndarje Strategjike - është shpërndarja gjatë një periudhe afatgjatë që zë çdo klasë aseti në portofol;

Tarifa e Administrimit - është komisioni që i paguhet Shoqërisë së Administrimit për menaxhimin e investimeve;

Tituj - tituj ose instrumente financiare të negociueshme që emetohen dhe tregtohen për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tyre. Mund të jenë tituj të pjesëmarrjes në kapital, tituj borxhi, aksione dhe kuota të Fondit të Investimeve ose Fondit të Pensioneve;

Tituj borxhi - janë obligacione të emetuara nga shtete, kompani private, apo organe të tjera.

Treg i rregulluar - çdo bursë, treg mbi banak ose çdo treg tjetër i organizuar i titujve, që vepron rregullisht, është i hapur për publikun dhe është i njohur zyrtarisht nga AMF-ja;

Tregu i parasë - Tregu i parasë i referohet tregtimit në instrumente borxhi afatshkurtra;

Vlera Neto e Aseteve - është vlera e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e llogaritjes;

Vlera Neto e Aseteve për kuotë - vlera neto e aseteve e pjesëtuar me numrin e kuotave totale të Fondit. Vlera Neto e aseteve për kuotë quhet ndryshe dhe çmimi i kuotës në ditën e vlerësimit.

3. SHOQËRIA ADMINISTRUES

3.1. Forma Ligjore

Albsig Invest Sh.a është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në regjistrin tregtar me NIPT: L92208025J, e licensuar nga AMF për të vepruar si Shoqëri Administruese e Fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me seli në adresën: Rruga e "Barrikadave", Albsig HQ, Tiranë, Shqipëri.

Aksionari i vetëm i Shoqërisë Administruese është "Albsig Jetë" Sh.a, e cila zotëron 100% të aksioneve. "Fondi i Investimit Albsig Standard" nuk mbështetet apo garantohet në çfarëdo lloj forme nga "Albsig Jetë" Sh.a, dhe rreziku i investimit i përket tërësisht investitorit.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 54,000,000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë.

Emri ligjor i shoqërisë është: Albsig Invest Sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

Albsig Invest Sh.a ka si objekt të aktivitetit të saj:

1. 1.Mbledhjen, investimin dhe kryerjen e pagesave për pension të fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e ligjore, si dhe bazuar në licensën nr. 5, datë 22.11.2019, të miratuar me vendimin nr. 210 nga AMF;
2. 2.Krijimin dhe administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat e ligjore,si dhe bazuar në licensën nr. 5, datë 22.11.2019, të miratuar me vendimin nr. 210 nga AMF.

Shoqëria Administruese gjatë aktivitetit të saj udhëhiqet nga parimet e qeverisjes së mirë, prioriteti i interesit të klientëve, integritetit, profesionalizmit, ligjet dhe rregulloret që bien mbi të.

3.2. Fondet nën administrim

Albsig Invest Sh.a. administron Fondet e mëposhtme:

1. Fondi i Pensionit Vullnetar Albsig (Ref. FP 4) miratuar nga AMF me vendimin nr. 210, datë 22.11.2019.
2. Fondi i Investimit Albsig Standard (Kodi F1-B5) miratuar nga AMF me vendimin nr. 255, datë 30/12/2019.

3.3. Organet drejtuese të Shoqërisë Administruese

Organet drejtuese të Shoqërisë Administruese janë: Asambleja e Aksionarëve, Këshilli i Administrimit dhe Administratorët.

3.3.1. Asambleja e Aksionarëve

Asambleja e Aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesi ligjor i aksionarit të vetëm të shoqërisë "Albsig Jetë" Sh.a.

3.3.2. Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit është organi qëndror i Shoqërisë Administruese i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të Shoqërisë Administruese. Ai kujdeset që Shoqëria Administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat financiare, të investimit, Prospektin etj. Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë si më poshtë:

1. **Z. Irfan LAMI: Kryetar i Këshillit të Administrimit**

Z. Irfan Lami ka karrierë të gjatë në fushën financiare prej vitit 1995. Z. Lami ka eksperiencë disavjeçare pranë ISSH në fushën e pensioneve, financës dhe auditimit. Ka eksperiencë mbi 18 vjeçare në menaxhimin financiar dhe drejtues të shoqërive të sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë. Prej vitit 2015 është Drejtor i Departamentit të Financës të Shoqërisë Albsig Sh.a. Z. Lami zotëron diplomë universitare e integruar e nivelit të dytë në Financë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, që nga viti 1995. Z. Lami ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit financiar dhe të riskut.

2. **Z. Dritan KASTRATI: Anëtar i Këshillit të Administrimit**

Z. Dritan Kastrati ka një eksperiencë disavjeçare pranë Byrosë Shqiptare të Sigurimeve, si specialist i trajtimit të dëmeve, sekretar i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve/Komisioneve dhe administrimit të praktikave të BSHS. Z. Kastrati prej vitit 2015 është pjesë e Albsig Sh.a si Drejtor i Departamentit të Dëmeve dhe Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm. Z. Kastrati zotëron diplomë master në Administrim Publik nga Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës . Z. Kastrati ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit (publik dhe të shoqërive private), të sigurimeve, trajtimit të dëmeve dhe riskut.

3. **Z. Elvis BEQIRI: Anëtar i Këshillit të Administrimit**

Z. Elvis Beqiri prej vitit 2017 është pjesë e shoqërisë Albsig Sh.a si Drejtor i Sigurimit të Përgjegjësive. Z. Beqiri ka një eksperiencë 14 vjeçare në fushën bankare në pozicione të ndryshme si Drejtor Departamenti, Drejtues Dege, etj. Z. Beqiri zotëron diplomë Master në Administrim Biznesit (MBA) nga Universiteti Polis dhe IPAG Business School, Paris. Z. Beqiri ka kryer trajnime të shumta në fushën e menaxhimit dhe financiare.

4. **Z. Elton KORBI: Anëtar i Këshillit të Administrimit**

Z. Elton Korbi është aktualisht Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Korbi ka një eksperiencë mbi 13 vjeçare në sektorin bankar në banka tregtare dhe në Bankën e Shqipërisë, në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, kontabilitetit dhe analizës financiare. Z. Korbi zotëron diplomë universitare të integruar të nivelit të

dytë në Financë nga Universiteti i Tiranës si dhe diplomë Master në Administrim Biznes (MBA) nga Universiteti Epoka. Z. Korbi nga viti 2015 është duke ndjekur studimet për marrjen e certifikatës ACCA (Association of Chartered Certified Accountants). Z. Korbi ka zhvilluar trajnime të shumta në fushën e auditimit, mbikëqyrjes, menaxhimit të riskut, menaxhimit financiar dhe buxhetimit nga institucione prestigjioze si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Deutsche Bundesbank, BaFIN, Banque de France, etj.

5. Z. Admir RAMADANI: Anëtar i Këshillit të Administrimit

Z. Admir Ramadani është aktualisht Drejtor i Investimeve dhe Zëvendës Administrator i Përgjithshëm i Albsig Invest Sh.a. Z. Ramadani ka një eksperiencë 13 vjeçare në sektorin bankar, nga të cilat 5 vjet në fushën e investimeve si dhe 8 vite në fushën e menaxhimit të risqeve. Z. Ramadani zotëron dy diploma në Ekonomiks dhe Matematikë nga Universiteti Amerikan në Bullgari. Z. Ramadani zotëron titullin CFA (Chartered Financial Analyst) që nga Tetor 2012.

3.3.3. Administratorët

Veprimtaria e përditshme e Shoqërisë Administruese menaxhohet nga administratorët të cilët janë njëkohësisht edhe anëtarë të Këshillit të Administrimit. Administratorët organizojnë dhe menaxhojnë veprimtarinë e Shoqërisë Administruese, përgatisin dhe propozojnë për miratim në Këshillin e Administrimit politikat e biznesit, rregulloret dhe procedurat e brendshme, raportet e zhvillimit të biznesit si dhe raportet financiare, vendosin mbi të drejtat dhe detyrimet e punonjësve që rrjedhin nga kontratat e punës, etj.

Administratorët janë:

1. Z. Elton KORBI, MBA - Administrator i Përgjithshëm;
2. Z. Admir RAMADANI, CFA - Zëvendës Administrator i Përgjithshëm.

3.3.4. Personeli Kyç:

1. Z. Admir Ramadani — Drejtori i Investimeve
2. Znj. Klejda Ballia - Njësia e Menaxhimit të Riskut.

4. DELEGIMI I DISA FUNKSIONEVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TEK PALËT E TRETA

Shoqëria Administruese ka lidhur një kontratë për delegimin e disa funksioneve të saj me shoqërinë Albsig Sh.a. në mënyrë që të shfrytëzojmë kapacitetet e saj të konsoliduara

Funksionet e deleguara do jenë:

- Shërbimet ligjore, përputhshmëria dhe parandalimi i pastrimit të parave të veprimtarisë së administrimit;
- Shërbimet e menaxhimit të burimeve njerëzore;

- Shërbimin e auditimit të brendshëm;
- Shërbimet e marketingut dhe prokurimeve;
- Shërbimin e administrimit të teknologjisë së informacionit;
- Shërbimet e arkivimit dhe të protokollit; si dhe
- Shërbimet e mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

Synimin i delegimit të këtyre funksioneve të mësipërme ka të bëjë me rritjen e efektivitetit, nisur edhe nga eksperienca e Albsig Sh.a në treg ku dallohet për cilësinë dhe besueshmërinë e shërbimeve të saj ndaj klientëve, kjo e vërtetuar nga raportet periodike të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe rrjeti i shpërndarjes mjaft i gjerë dhe i konsoliduar. Pavarësisht këtij delegimi, Shoqëria Administruese mbetet përgjegjëse për këto funksione të deleguara. Albsig Sh.a ka marr masa që të mënjanoj çdo konflikt interesi gjatë kryerjes së funksioneve të deleguara ndaj Albsig Invest Sh.a.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare informohet për çdo funksion të deleguar.

5. FONDI I INVESTIMIT

Në Fond mund të investojnë investitorë individualë dhe investitorë institucional (kompanitë e sigurimit, fondet e pensionit, etj). Kohëzgjatja e rekomanduar e qëndrimit në Fond është të paktën 2 vjet. Fondi është një alternative shumë e mirë për klient konservator që kërkojnë fleksibilitet të lartë mbi kursimet e tyre. Fondi të jep mundësinë që vetëm me një kontratë të vetme mund të investosh dhe mund të tërheqësh kur dhe sa dëshiron nga fondet e akumuluara fondet e akumuluara. Fondi është fond akumulimi i cili i ri-investon të ardhurat e gjeneruara nga asetet e tij. Ofron vetëm një klasë kuote e cila është në Lekë, dhe mbart tarifat dhe komisionet të shprehura në këtë prospekt. Ky Fond është me kohëzgjatje të papërcaktuar. Fondi nuk mbështetet në asnjë formë nga Albsig Invest apo Albsig Jetë për stabilitetin e vlerës neto të aseteve apo për mbështetje likuiditeti, në këtë mënyrë rreziku i investimit i përket tërësisht investitorit.

Investimet në Fond nuk konsiderohen si depozita bankare dhe si të tilla nuk janë të siguruara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD). Kuotat e Fondit blihen dhe shiten vetëm në monedhën Shqiptare, lekë.

5.1. Politika e investimit

Politika e investimit përbën elementin kryesor të Prospektit pasi marrëdhënia midis investitorit dhe Shoqërisë Administruese lind kur investitori bie dakord që investimi i tij të kryhet në klasat e aseteve që përshkruhen në këtë politikë. Shoqëria Administruese respekton të gjitha kufizimet e investimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 56/220 " Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", kufizimet e politikës së Investimit dhe politikës së menaxhimit të rrezikut. Fondi do të investojë kryesisht në bono dhe obligacione të Shtetit Shqiptar dhe i adresohet klientëve konservativ me një horizont afatmesëm investimi 2-5 vjet duke ofruar likuiditet të lartë.

Performanca e Fondit mund të luhatet në varësi të ndryshimeve të normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Shtetit Shqiptarë të cilat ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve të kushteve të tregut.. Performanca e kaluar nuk garanton një performancë të caktuar në të ardhmen dhe Shoqëria Administruese nuk mund të garantojë një performancë të caktuar për Fondin.

Elementet kryesore të politikës së investimit janë:

1. Objektivi: Fondi synon rritje të të ardhurave duke ruajtur principalin dhe likuiditetin.;
2. Toleranca për rrezik: E ulët;
3. Horizonti i Investimit: Afatmesëm (2-5 vjet).

Shoqëria Administruese do të synojë të ndërtojë një shpërndarje strategjike si më poshtë. Me një shpërndarje strategjike nënkuptohet se në cilat lloje asetesh, mesatarisht në një kohë afatgjatë, do të jetë i investuar Fondi. Shoqëria Administruese për të diversifikuar Fondin ka shtuar në shpërndarje dhe tituj të emetuar nga autoritete vendore dhe shoqëri tregtare në Republikën e Shqipërisë por në një masë të vogël, e cila nuk ndikon mbi tolerancën e ulët për rrezik që duhet të ketë Fondi. Letrat me vlerë të emetuara nga shoqëri tregtare dhe organe vendore do të jenë vetëm tituj që tregtohen në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë.

Shpërndarja e synuar e shprehur si objektiv mund të ndryshojë në varësi të kushteve të tregut dhe shërben vetëm si një orientim.

5.2. Alokimi Strategjik

Nr.	Kategoria e Aseteve	Objektivi	Maksimum
1	Tituj shtetëror të emetuar e garantuar nga Republika e Shqipërisë	90%	100%
2	Cash dhe ekuivalent të tij	10%	80%
3	Tituj të emetuar nga autoritete vendore dhe shoqëri tregtare të tregtuara në tregje të rregulluara ose në një bursë titujsh në Republikën e Shqipërisë	0%	10%

Objektivi i investimit do arrihet duke investuar pjesën më të madhe të portofolit në obligacione të Shtetit Shqiptar dhe duke menaxhuar duration-in (kohëzgjatjen) e tij në varësi të kushteve të tregut duke respektuar në çdo kohë limitin e duration prej 5 vjet.

Likuiditeti do të arrihet duke mbajtur cash dhe depozita me afat maturimi deri në 7 (shtatë) ditë të paktën 10% të portofolit. Gjithashtu likuiditeti do të realizohet duke investuar një pjesë të konsiderueshme të portofolit në obligacione të ashtuquajtura "referencë" të emetuar nga Shteti Shqiptar, të cilat tregtohen rregullisht nga zhvilluesit e tregut. Stabiliteti i principalit vjen nga rreziku më i ulët i kreditit që zotërojnë bonot dhe obligacionet e Republikës së Shqipërisë në krahasim me obligacionet e shoqërive tregtare apo instrumenteve të tjera financiare.

Rreziku i kredisë është i lidhur ngushtë me aftësinë paguese të Shtetit Shqiptar dhe është e pamundur që ai të përjashtohet plotësisht. Rreziku i kredisë do të zbutet duke diversifikuar portofolin e letrave me vlerë. Fondi do të jetë i investuar gjithmonë në të paktën gjashtë emetime të ndryshme me numra të ndryshëm ndërkombëtarë të identifikimit të titujve (ISIN) ose të barasvlershëm të tyre.

Shoqëria Administruese do të zbatojë në mënyre rigoroze rregulloret mbi likuiditetin miratuar nga AMF.

Fondi nuk do të nënshkruajë kontrata derivative.

Instrumentet e listuara në alokimin strategjik janë në përputhje me investimet e lejuara në Ligjin Nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive.

6. FAKTORËT E RREZIKUT

6.1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Administruese ka një strukturë të veçantë për menaxhimin e rrezikut e cila kontrollon nëse investimet e Fondit kryhen brenda kufizimeve të vendosura për rreziqet. Njësia e menaxhimit të rrezikut është përgjegjëse për vlerësimin e aseteve të Fondit dhe ka ndërtuar politika dhe procedura për menaxhimin e çdo lloj rreziku që ekspozohet Fondi.

Investimi në instrumente financiare shoqërohet gjithmonë me një rrezik. Rreziku nuk mund të eliminohet plotësisht dhe investitorët janë të ekspozuar ndaj humbjeve. Çdo tip aseti si obligacione, aksione apo letra të tjera me vlerë zotërojnë tipare të ndryshme rreziku. Investitori duke njohur tolerancën e tij për rrezik zgjedh në cilin Fond të investojë duke parë se në çfarë asetesh investon ky Fond.

"Fondi i Investimit Albsig Standard" do të investojë kryesisht në bono dhe obligacione të emetuara nga Republika e Shqipërisë dhe për rrjedhojë rreziku në Fond është i lidhur ngushtë me aftësinë paguese dhe rrezikun në përgjithësi të Shtetit Shqiptar. Rreziku nga bonot dhe obligacionet qeveritare tradicionalisht vlerësohet më i ulët se obligacionet apo aksionet e kompanive private. Fondi mund të investojë dhe në tituj të emetuar nga autoritete vendore dhe shoqëri tregtare në Republikën e Shqipërisë të cilat kanë një rrezik kredie më të lartë se bonot dhe obligacionet e Shtetit Shqiptar, por në një masë të vogël, e cila kryhet vetëm për qëllime diversifikimi.

Pavarësisht se Fondi do të investojë kryesisht në bono dhe obligacione të Shtetit Shqiptar të cilat kanë rrezik kredie më të ulët se asetet e tjera të tregjeve të kapitalit, ato mbartin rrezikun nga normat e interesit dhe të likuiditetit.

6.2. Rreziqet e lidhura me investimit

Në momentin e vendimmarrjes për investime, Shoqëria Administruese trajton çdo investim të veçantë brenda kontekstit të nivelit të përgjithshëm të riskut për

totalin e aseteve të fondit, në përputhje me parimet e sigurisë, pë¬tueshmërisë, likuiditetit dhe diversi¬kimit të riskut.

a) Rreziku i Tregut

Nënkupton luhatjet e vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve të:

i. normave të interesit,
ii. të kurseve të këmbimit.

Rritja e normave të interesit sjell ulje të vlerës së instrumentit financiar, dhe ulja e normave sjell rritje të vlerës së instrumentit financiar. Luhatjet e kursit të këmbimit sjellin luhatje të vlerës së asetit të konvertuara në monedhën vendase, lekë. Fondi nuk ka parashikuar në shpërndarjen e tij asete në valutë të huaj.
Si rrjedhojë e ndryshimeve të normave të interesit investitori në periudha afatshkurtra mund të humbasë pjesë të kapitalit. Por një karakteristikë e bonove dhe obligacioneve është se nëse emetuesi nuk falimenton, investitori do të sigurojë një normë kthimi sa norma e kuponit vetëm nëse e mban bonon apo obligacionin deri në maturim.
Njësia matëse e rrezikut nga normat e interesit është "duration" apo "kohëzgjatja".

Duration (kohëzgjatja): Kohëzgjatja është matësi i rrezikut nga normat e interesit të një letre me vlerë me të ardhura fikse (obligacion) që tregon ndjeshmërinë e çmimit të një letre me vlerë nga ndryshimet e normave të interesit. Sa më e madhe të jetë kohëzgjatja, aq më e madhe do të jetë ndjeshmëria dhe për rrjedhojë ndryshimi i vlerës së tregut të letrës me vlerë nga ndryshimi i normave të interesit. Një Fond me një kohëzgjatje mesatare më të lartë do të jetë më e ndjeshme në krahasim me një Fond me një kohëzgjatje më të vogël.

Si shembull: për një Fond me një kohëzgjatje të barabartë me 4 (katër) vjet, vlera e tij do të bjerë me 4% nëse normat e interesit rriten me 1%.

Kufiri i kohëzgjatjes mesatare të Fondit do të jetë më e vogël ose e barabartë me 5 (pesë) vjet.

Shoqëria Administruese menaxhon rrezikun nga normat e interesit dhe likuiditetit duke përdorur strategjinë e menaxhimit të duration-it (kohëzgjatjes) të bonove dhe obligacioneve që nënkupton uljen apo rritjen e duration (kohëzgjatjes) në varësi të kushteve të tregut.

b) Rreziku i Kredisë

Nënkupton mospagimin e emetuesit të instrumentit financiar për të paguar detyrimet e tij në formë interesi periodik dhe principali. Gjithashtu përkeqësimi i aftësisë paguese të një emetuesi reflektohet direkt te çmimi i obligacionit duke e ulur atë dhe duke ulur për rrjedhojë vlerën neto të aseteve. Përkeqësimi i aftësisë paguese të një shteti vjen zakonisht nga përkeqësimi i deficitit buxhetor.

Bonot dhe Obligacionet kanë një Rating (vlerësim i letrave me vlerë) i cili reflekton një "notë" për aftësitë paguese të emetuesit. Ndryshimi i aftësisë paguese reflektohet në ndryshimin e "rating" të emetuesit.

Investimi në obligacione të Shtetit Shqiptar është i lidhur me aftësitë paguese të Shtetit Shqiptar. Fondi është i përqëndruar kryesisht te rreziku i kredisë së Shtetit Shqiptar. Tradicionalisht rreziku i kredisë vlerësohet më i ulët për obligacionet shtetërore në krahasim me asetet e tjera si obligacionet apo aksionet e shoqërive tregtare.

Tituj të emetuar nga autoritete vendore dhe shoqëri tregtare në Republikën e Shqipërisë përmbajnë rrezikun e kredisë të entitetit apo kompanisë që i emeton, dhe kryesisht vlerësohen me rrezik kredie më të lartë se bonot dhe obligacionet shtetërore. Fondi ka parashikuar një shpërndarje të vogël në këtë klasë aseti, vetëm për qëllime diversifikimi, e cila nuk ndikon përfundimisht në rrezikun total të Fondit.

c) Rreziku i Likuiditetit

Përbën pamundësinë për të shitur asetet e Fondit në rast kur shoqëria duhet të përmbushë detyrimet e saj për tërheqje apo shitja e asetit me çmim të pafavorshëm. Investimi i Fondit në asete jo-likuide mund të sjellë ulje të normës së kthimit kur aseti shitet vetëm me një çmim shumë të pafavorshëm.

Shoqëria Administruese do të mbajë në çdo kohë të paktën 10% të portofolit në cash apo depozita me maturim të mbetur më të vogël se 7 (shtatë) ditë dhe një pjesë të konsiderueshme në obligacione "referencë" të cilat kuotohen çdo ditë nga zhvilluesit e tregut.

Shoqëria Administruese do të zbatojë në mënyrë rigoroze rregulloren nr. 21, datë 06.02.2018 "Për administrimin e likuiditetit për Fondin e Investimeve" e miratuar nga AMF.

d) Rreziku i palës tjetër:

Shoqëria Administruese në emër të Fondit kryen transaksione ose transferta me palë të tjera, të cilat mund të mos kryhen apo të kryhen me vonesë si pasojë e mos zbatimit të kushteve të marrëveshjes mes palëve.

e) Rreziku i mos-diversifikimit:

Fondi do të investojë kryesisht në bono dhe obligacione të Shtetit Shqiptar dhe është i ekspozuar nga rreziku i mos-diversifikimit. Kjo mund të sjellë luhatje të mëdha në performancën e Fondit pasi bëhet më i ndjeshëm ndaj çdo përkeqësimi të aftësisë paguese të Shtetit Shqiptar.

Rreziku i vlerësimit të aseteve:

Investimet në tregje jo-likuide si ai i bonove dhe i obligacioneve të Shtetit Shqiptar vështirëson vlerësimin e këtyre aseteve duke mos pasur mundësi gjetjen e çmimit direkt në këto tregje. Përdorimi i metodologjive për vlerësimin e aseteve jo-likuide shoqërohet gjithmonë me vështirësinë nëse do duhej kryerja e shitjeve të tyre pasi këto metodologji përmbajnë elemente subjektive që përafrojnë vlerën e drejtë të asetit.

f) Rreziku i i shlyerjeve të mëdha:
Shlyerjet e mëdha mund të vendosin në vështirësi Fondin nëse ai është i detyruar të kryejë shitje të një pjese të madhe të portofolit. Shitjet e detyruara në vlera të mëdha kryhen me çmime të pafavorshme të cilat sjellin humbje për Fondin.

6.3. Rreziqet e lidhura me shoqërinë administruese

g) Rreziku Operacional:
Përbën humbjet e mundshme nga gabime apo nga keqfunksionimi i sistemeve të brendshme apo procedurave të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese ndërton sisteme kontrolli të brendshme dhe procedura duke parandaluar rrezikun e humbjeve të Fondit të shkaktuara nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda Shoqërisë Administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e tregtimit, të vlerësimit dhe pagesave në emër të Fondit. Shoqëria Administruese për të administruar Fondin përdor një sistem operativ i cili është ndërtuar duke respektuar parimin e 4 (katër) syve.

Gjithashtu Banka Depozitare kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me investitorët (investimet dhe shlyerjet).

h) Rreziku i Përputhshmërisë:
Shoqëritë e Administrimit të Fondeve të pensionit dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive operojnë në një treg që është i rregulluar. Si të tilla ato janë të ekspozuara nga rreziku i mos përmbushjes së akteve ligjore apo i rregulloreve që bien mbi to. Ky rrezik mund të sjellë efekte negative për shkak të mos zbatimit të rregulloreve, kryesisht ato që rregullojnë nivelin e kapitalit dhe parandalimit të pastrimit të parave.

Shoqëria Administruese ka ndërtuar bazën e plotë rregullatore të brendshme për të shmangur rrezikun e përputhshmërisë. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon aktivitetin e investimeve dhe të transaksioneve me investitorët (investimet dhe shlyerjet) nëse ai është në përputhje me rregulloret dhe Prospektin.

Shoqëria Administruese do të ndërtojë një sistem solid të vlerësimit periodik të aseteve, humbjeve të mundshme dhe mundësisë së rritjes së kapitalit. Në të njëjtën kohë do të informojë çdo anëtar të Fondit në mënyrë elektronike për rregullat e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

i) Rreziku i Agjencisë:
Rreziku i agjencisë ndodh kur administratorët e Shoqërisë Administruese apo dhe menaxherët e portofolit nuk marrin vendim për rritjen e fitimit afatgjatë të Shoqërisë Administruese apo në shërbim të klientit, por nisen nga synimet e tyre personale afatshkurtra.

Shoqëria Administruese ka ngritur rregullore të brendshme të cilat vendosin rregulla mbi sjelljet e menaxherëve të portofolit dhe administratorëve të Shoqërisë Administruese. Banka Depozitare gjithashtu kontrollon procesin e investimeve dhe të transaksioneve të investitorëve dhe është një element i rëndësishëm kontrolli.

j) Rreziku i Reputacionit:

Rreziku i reputacionit është një dëmtim i emrit të mirë të Shoqërisë Administruese apo grupit ku ajo bën pjesë. Ky rrezik mund të vijë nga sjellja e Shoqërisë Administruese apo nga sjelljet e punonjësve të Shoqërisë Administruese.

Shoqëria Administruese ndjek parime të mirëqeverisjes të shprehura në rregulloren e brendshme të saj dhe ka ndërtuar rregulla për komunikimin dhe transparencën me klientët të cilët garantojnë standarde të larta për mirëmbajtjen e reputacionit të Shoqërisë Administruese.

k) Rreziku i personelit kyç:

Administratorët e Shoqërisë Administruese dhe menaxherët e portofolit janë kryesisht përgjegjës për performancën e Fondit dhe kjo performancë varet nga aftësitë profesionale të tyre, vendimmarrja e duhur dhe konsistenca e veprimeve të tyre. Gjithashtu ky staf i Shoqërisë Administruese mund të ndryshojë duke sjellë vështirësi në vijueshmërinë e aktivitetit.

Rreziku nga delegimi i funksioneve

Funksionet e deleguara në të njëjtën mënyrë si rreziku i agjensisë mund mos të kryen në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Shoqërisë Administruese, dhe Shoqëria Administruese është përgjegjëse përfundimtare para klientëve të saj për këto shërbime.

6.4. Rreziqet që ndikojnë te investitorët dhe shoqëria

l) Rreziku Ligjor

Rreziku ligjor shfaqet si pasojë e ndryshimeve në legjislacionin shqiptar në lidhje me Fondet e Investimit. Ndryshime të tilla mund të sjellin ndryshime në strategjinë e investimit, shpërndarjen strategjike dhe kushtet të tjera që mund të ndryshojnë pritshmëritë e investitorëve për Fondin.

Rreziku i pezullimit të shlyerjes së kuotave:

Investitori mund të kërkojë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tij. Por në përputhje me rregulloren nr. 154, datë 29.09.2016 "Mbi pezullimin e shitjes së shlyerjes së kuotave në Fondet e Investimeve", Shoqëria mund të pezullojë shlyerjen e kuotave në rrethana të jashtëzakonshme siç mund të jenë: a) ngjarje politike, ekonomike, ushtarake, ngjarjet e politikës monetare ose sociale, etj., në ndikimin e të cilave vlerësimi, blerja apo shitja e aseteve të Fondit nuk është e mundur të kryhet siç do të kryhej në kushte normale; b) situata e krizave financiare që çojnë në mbylljen e tregjeve financiare; c) ndërprerja apo prishja për arsye madhore e mjeteve të zakonshme të komunikimit; d) raste të tjera të gjykuara nga AMF si të nevojshme për të mbrojtur interesat e kuota mbajtësve në një Fond apo Fonde të veçanta.

m) Rreziku i Depozitarit:
Funksioni i Bankës Depozitare është i një rëndësie të madhe. Kjo bankë liçensohet nga Banka e Shqipërisë dhe nga AMF për kryerjen e këtij funksioni. Për arsye të ndryshme operacionale ajo mund të mos kryej përllogaritjen e vlerës së aseteve neto në kohë apo mund të sjell vonesa në kryerjen e transaksioneve me letrat me vlerë.

7. TË DREJTAT NGA KUOTAT E FONDIT

Nga momenti i zotërimit të kuotave nëpërmjet aktit të blerjeve së tyre, investitori mund të kërkojë lëshimin e një certifikate që vërteton pronësinë e tyre. Kjo certifikatë lëshohet me kërkesë të investitorit brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga kryerja e pagesës për blerjen e kuotave dhe përmban të dhëna mbi numrin e kuotave, çmimin e blerjes, të dhënat mbi Fondin dhe nënshkrimin e Shoqërisë Administruese.
Të drejtat që lidhen nga pronësia e kuotave në Fond janë:

- E drejta e informacioni;
- E drejta për shlyerjen e kuotave;
- E drejta për të marrë pjesë në fitimin e Fondit në mënyrë proporcionale me pjesëmarrjen në të;
- E drejta që asetet e Fondit, në rast falimenti të Shoqërisë Administruese të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.

Fondi zotëron vetëm një klasë kuotash e cila zotëron kushtet e shprehura në këtë prospekt. Të ardhurat nga asetet ri-investohen(kuota akumuluese).

Mbajtësit e kuotave nuk mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mos veprimet e Shoqërisë Administruese apo Depozitarit.

Shoqëria Administruese mban regjistrin e kuotave të fondit. Depozitari mban gjithashtu këtë regjistër dhe rikoncilon me Shoqërinë Administruese çdo veprim në këtë regjistër në përputhje me Ligjin Nr. 56/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. MËNYRA DHE KUSHTET E BLERJES APO SHLYERJES SË KUOTAVE

8.1. Blerja e kuotave

Blerja e kuotave do të kryhet nëpërmjet: a) pagesës së aseteve monetare, ku blerësi hyn në një marrëdhënie kontraktuale me Shoqërinë Administruese në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt, b)këmbimit të kuotave të fondeve të tjera të investimit në të njëjtën monedhë, të menaxhuara nga e njëjta Shoqëri Administruese, dhe c) titujve apo aseteve që janë të tregtuara në tregje të organizuara dhe të rregulluara, ku është e mundur të përcaktohet çmimi i tyre i saktë, të parashikuar nga rregulloret që miraton AMF-ja.

Blerja e kuotave nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së blerjes do të bëhet pranë Shoqërisë Administruese me adresë Rr. Barrikadave, Albsig HQ, 1001, Tiranë, rrjetit të kompanisë së sigurimit Albsig Sh.a dhe agjentëve që kanë lidhur kontratë me Shoqërinë Administruese për shërbimin e agjentit të Fondit të pensionit. Listën e

rrjetit të agjentëve të Fondit së bashku me vendndodhjen e tyre e gjeni në adresën e publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë, në rubrikën Shërbimet/Rrjeti Agjentëve.

Nëse kërkesa për blerje mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e Fondit të investimit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në Fond.

Blerja e kuotave nëpërmjet një kontrate mund të kryhet si më poshtë:

1. Pagesë e menjëhershme e cila nënkupton investimin e një shume të vetme;
2. Plan investimi, i cili nënkupton një investim periodik nëpërmjet pagesave të rregullta në vazhdimësi.

Shuma minimale e pagesës së menjëhershme është 10,000 (dhjetë mijë) lekë. Shuma minimale e planit të investimit është 1,000 (një mijë) lekë.

Çdo pagesë për blerje kuotash (e ndarë si proces nga procesi i blerjes së kuotave nëpërmjet kontratës së blerjes) kryhet në llogarinë bankare të Fondit me **IBAN: AL49 2061 1004 0000 1003 2129 9100**, të hapur pranë Bankës Depozitare, e cili është Banka Tirana Sh.a., në një nga mënyrat e mëposhtme:

1. Pagesë cash direkt në llogarinë pranë Bankës Depozitare;
2. Transfertë nga llogaria e investitorit (pranë çdo banke tjetër të nivelit të dytë) drejt llogarisë së Fondit, kundrejt kushteve të punës.

Investitori do të nënshkruajë një kërkesë blerjeje dhe do të bëhet pronar i një numri të caktuar kuotash vetëm në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Data e blerjes së kuotave dhe çmimi i blerjes së tyre është data kur pagesa (apo transferta) për to ka mbërritur në llogarinë e Fondit pranë Bankës Depozitare.

Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond, i llogaritur në përputhje me Ligjin Nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", rregulloret në zbatim te tij, si dhe në përputhje me këtë Prospekt.

Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 (katër) shifra pas presjes dhjetore Secili kuota-mbajtës është bashkëpronar i aseteve të fondit në përpjesëtim me numrin e kuotave që ai zotëron.

Shembull blerje kuote:
Gjatë ofertës fillestare të Fondit, çmimi i emetimit për kuotë është 1,000 lekë

Çmimi i kuotës në ditën e pagesës së shumës për investim	1,000 lekë
Shuma e investimit	5,000 lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond (ALL 5,000 / ALL 1,000)	5 kuota

Shuma e derdhur nga investitori do investohet në asetet e shprehur te seksioni mbi politikën e investimit. Çmimi i kuotës reflekton rritjen e investimit nga norma e kthimit e aseteve në fond.

Blerja e një kuote mbas muajit fillestar:

Çmimi i kuotës në ditën e pagesës së shumës për investim	1,200 lekë
Shuma e investimit	5,000 lekë
Numri i kuotave të anëtarit në Fond (ALL 5,000 / ALL 1,200)	4.167 kuota

Numri total i kuotave në pronësi të anëtarit do jetë: 5 kuota nga blerja e parë + 4.167 kuota të blerë nga blerja e dytë = 9.167 kuota. Në datën e blerjes së dytë kur çmimi i kuotës është 1,200 lekë, balanca e klienti në lek është e barabarte me 9,167 kuota shumëzuar me çmimin 1,200 lekë ose 11,000.04 lekë.

Nëse në një datë të mëvonshme çmimi i kuotës do shoje në 1,500 Lekë, dhe investitori nuk ka kryer më investime, balanca e tij në fond do jetë: 9,167 kuota shumëzuar me çmimin, 1,500 lekë e barabartë me 13,750.5 lekë.

8.2. Shlyerja e kuotave

Investitorët apo mbajtësit e kuotave kanë të drejtë që të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave. Investitori duke u paraqitur pranë selisë së Shoqërisë Administruese në adresën Rruga e "Barrikadave", Albsig HQ, Kati 8, Tiranë, apo pranë agjentëve që kanë lidhur një kontratë për kryerjen e shërbimit të shitjes (adresa e tyre ndodhet në faqen e internetit të Shoqërisë Administruese tek seksioni Shërbimet/Rrjeti Agjentëve) duhet të nënshkruajë një kërkesë për shitjen e kuotave. Në këtë kërkesë për shitje apo shlyerje të kuotave, investitori duhet të vendosë dhe numrin e llogarisë të një banke të nivelit të dytë pasi asetet monetare do të kalojnë nga llogaria e Fondit pranë Bankës Depozitare drejt llogarisë së investitorit.

Nëse kërkesa për shlyerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

Shoqëria Administruese duhet të respektojë kërkesën e investitorëve për shlyerjen e kuotave jo më gjatë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e regjistrimit të kërkesës për tërheqje. Çmimi i zbatueshëm për tërheqje është ai i datës së regjistrimit të kërkesës.

Çdo pagesë bëhet në mjete monetare, përjashtuar rasteve të veçanta kur instrumentet financiare të Fondit janë të tregtuara në tregje të organizuara ose të rregulluara, kur është i mundur të përcaktohet çmimi i tyre i saktë, dhe vetëm në këtë rast pagesa mund të kryhet në instrumente financiare. Në rrethana të veçanta, kur shitja e aseteve të Fondit, e nevojshme për të plotësuar kërkesat për shlyerjen në vlera të mëdha, mund të kompromet ojë pozicionin e investitorëve të përhershëm në Fond, shlyerja e kuotave mund të bëhet duke përdorur instrumentet financiare të Fondit. Shlyerja me instrumente financiare mund të bëhet vetëm duke transferuar atë pjesë të çdo lloji aseti të Fondit, e cila

është në përpjesëtim me numrin e kuotave të investitorëve, që kërkojnë shlyerjen dhe vlerën totale të aseteve të Fondit.

Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 (katër) shifra pas presjes dhjetore.

9. PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE TË FONDIT

Shlyerja dhe shitja e kuotave të Fondit mund të pezullohet në rastet kur:

1. Shoqëria Administruese dhe Depozitari vlerësojnë se rrethanat janë të të jashtëzakonshme dhe se ka arsye të forta e të justifikuara, për pezullimin e shlyerjes dhe shitjes, në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave ose të mbajtësve potencialë.
2. Nëse Shoqëria Administruese merr vendim për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave dhe nëse depozitari nuk është dakord me një vendim të tillë, ky i fundit njofton menjëherë AMF.
3. Shoqëria Administruese, në çdo rast, i njofton menjëherë AMF-së vendimin për pezullim të shitjes dhe shlyerjes së kuotave. AMF, pas marrjes së njoftimit nga Shoqëria Administruese për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave, mund të urdhërojë anulimin e këtij vendimi, nëse gjykon se është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në Fond. Shoqëria Administruese publikon menjëherë të dhënat për çdo pezullim të shitjes dhe shlyerjes së kuotave, në faqen e saj zyrtare të internetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së pezullimit, si dhe në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Shlyerja dhe shitja e kuotave në një Fond investimi mund të pezullohet edhe nga AMF-ja, e cila mund të urdhërojë Shoqërinë Administruese dhe depozitarin të pezullojë përkohësisht shlyerjen dhe shitjen e kuotave nëse ekzistojnë shkaqe të forta dhe të justifikuara për këtë pezullim dhe nëse kjo është në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave ose të mbajtësve potencialë.
5. Pezullimi i shlyerjes së kuotave duhet të mbarojë sa më shpejt që të jetë e mundur, ose menjëherë sapo arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes nuk ekzistojnë më dhe jo më vonë se 20 (njëzet) ditë pune nga fillimi i pezullimit, përveçse nëse AMF-ja jep miratimin me shkrim për zgjatjen e kufirit të dhënë kohor. Rifillimi i veprimtarisë tregtare në një Fond investimi i njoftohet pa vonesë AMF-së, dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shoqërisë Administruese, si dhe publikohet në një gazetë të përditshme, në qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë pezullimit të shlyerjes dhe shitjes së kuotave, Shoqëria Administruese dhe agjentët e saj të shitjes mund të vazhdojnë të marrin kërkesa për shitjen ose shlyerjen e kuotave, që do të ekzekutohen menjëherë pasi të jenë llogaritur çmimet e tjera të shlyerjes dhe shitjes, por palëve porositëse u bëhet e qartë se porositë e tyre nuk do të përmbushen brenda kufijve kohorë, të përshkruar në Prospektin dhe rregullat e Fondit.

Nëse në një ditë tregtimi bëhen kërkesa për shlyerje të kuotave, për më shumë se 10% të vlerës së aseteve neto të Fondit, atëherë shlyerja e shumës a vlerës përtej këtij kufiri do të shtyhet në pikën e ardhshme të investimit. Shoqëria Administruese garanton trajtim të njëllojtë të të gjithë mbajtësve të kuotave që kanë depozituar kërkesat për shlyerje të kuotave në ditën që kufiri prej 10% të vlerës të aseteve neto të fondit është kaluar.

10. KËMBIMI I KUOTAVE

Mbajtësit e kuotave apo investitorët në fond mund t'i këmbejnë ato me kuota të një Fondi tjetër Investimi, të menaxhuara nga e njëjta Shoqëri Administruese në të njëjtën monedhë,.

Investitor që dëshiron të këmbejë kuota do të nënshkruajë një kërkesë për këmbim kuotash. Për këmbimin e kuotave, numri i kuotave të reja të blera do të përcaktohet duke iu referuar çmimeve përkatëse të kuotave të reja dhe kuotave të vjetra në datën e vlerësimit kur do ndodh. Këmbimi nuk do të kryhet gjatë periudhës kur e drejta për shlyerje është pezulluar. Këmbimi i kuotave midis dy Fondeve të Investimit do të kryhet vetëm në një ditë pune kur të dy Fondet kanë mundur të nxjerrin çmimet përkatëse të kuotave. Efekti fiskal i këmbimit të kuotave është i njëjtë si në rastin e shitjes apo shlyerjes së tyre nga investitori.

11. TRANSFERIMI I KUOTAVE TË FONDIT

Çdo investitor ka të drejtë t'i transferojë kuotat që zotëron nëpërmjet një akti transferimi të miratuar nga Shoqëria Administruese. Shoqëria Administruese nuk kryen kalimin në fjalë nëse është e ndaluar nga Ligji nr. 56/20 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive".

Çdo urdhër transferimi nënshkruhet nga ose në emër të mbajtësit të kuotave që transferon kuotat ose në rastin e subjektit juridik, duhet të mbajë vulën e këtij subjekti ose të nënshkruhet nga një ose më shumë nëpunës të subjektit që kanë autorizimin përkatës për nënshkrimin dhe transferuesi trajtohet si pjesëmarrës deri në momentin kur emri i marrësit të jetë regjistruar në regjistër. Transferimi i kuotave është subjekt tatimi sipas legjislacionit në fuqi.

Shoqëria Administruese nuk do aplikojë tarifë transferimi.

Çdo urdhër transferimi do shoqërohet me dokumentin e nevojshëm përkatës.

12. HUMBJA E JETËS SË ANËTARIT

Nëse investitori humb jetën përpara marrjes së të gjitha aseteve të veta në Fond, asetet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

13. BASHKIMI DHE MBYLLJA E FONDIT

13.1. Bashkimi i fondit me një fond tjetër

Fondi i investimit Albsig Standard mund të bashkohet vetëm me një fond investimesh me ofertë publike. Fondi i investimit Albsig Standard mund të jetë një fond që bashkohet ose një fond marrës. Një marrëveshje bashkimi lidhet mes Këshillave të Administrimit të shoqërive administruese të fondeve që bashkohen. Autoriteti miraton paraprakisht çdo bashkim të fondeve të investimit me ofertë publike. Mbajtësit e kuotave në fondet që bashkohen përfitojnë një vlerë të barasvlershme kuotash në fondin pjesëmarrës në bashkim në datën e bashkimit. Për të arritur këtë, nëse është e nevojshme, mbajtësve të kuotave mund t'u ofrohen pagesa të vogla kompensuese në para.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet të Fondit që bashkohet i kalohen një fondi ekzistues (ose të krijuar rishtazi) marrës. Mbajtësit e kuotave në fondet pjesëmarrëse në bashkim marrin kuotat në fondin marrës dhe fondet pjesëmarrëse në bashkim prishen.

Mbajtësit e kuotave të fondeve bashkuese dhe marrëse kanë të drejtë t'i shlyejnë kuotat e tyre pa pagesë ose t'i këmbejnë kuotat e fondit që do të bashkohet me kuota të një fondi tjetër me natyrë të ngjashme investimi, e cila administrohet nga e njëjta shoqëri administruese. E drejta e shlyerjes dhe këmbimit të kuotave është e vlefshme deri në 5 ditë punë, përpara datës së hyrjes në fuqi të bashkimit.

Rrethanat e mbylljes dhe të likuidimit:
Shoqëria Administruese mund të iniciojë mbylljen e Fondit, kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin nr.56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe në mënyrë të veçantë kur:

1. Ajo mbyll vullnetarisht aktivitetin e saj;
2. I nënshtrohet procedurave të falimentit dhe likuidimit si pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve;
3. AMF-ja i ka hequr përkohësisht ose në mënyrë të përhershme licensën.
4. Fondi nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm.
5. Depozitari dhe Shoqëria Administruese nuk përmbushin detyrat e tyre dhe nuk zëvendësohen brenda 60 ditëve pune.
6. Në përfundim të bashkimit me një fond tjetër marrës.

Fondi i investimit me ofertë publike likuidohet në momentin e heqjes së liçensës nga autoriteti.

13.2. Kërkesa për likuidim vullnetarë dhe procedura e likuidimit

Kërkesa për likuidim vullnetar i paraqitet AMF-së nga Shoqëria Administruese jo me pak se 3 (tre) muaj, përpara datës së propozuar të likuidimit. Shoqëria Administruese deklaron arsyet e kërkesës dhe paraqet planin kohor për likuidimin.

Mbas dhënies së miratimit nga AMF, mbajtësit e kuotave informohen lidhur me likuidimin. Ky informacion përmban:

a) a)arsyet e likuidimit;
b) pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave;
c) kostot përkatëse;

d) pasqyrat e aftësisë paguese;
e) datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetarë, dhe datën kur mbajtësit e kuotave do marrin pagesën në vlerë monetare të kuotave.

Kërkesa për likuidim vullnetar i paraqitet AMF-së nga Shoqëria Administruese jo me pak se 3(tre) muaj, përpara datës së propozuar të likuidimit. Shoqëria Administruese deklaron arsyet e kërkesës dhe paraqet planin kohor për likuidimin.

13.3. Procedura mbylljes nga transferimi i fondit

Kur fondi i investimit mbyllet si pasoj e transferimit të të gjithë aktivitetit te një fond marrës si pasoj e bashkimit, zbatohen procedurat e mëposhtme:

a) njoftimi për mbylljen i dërgohet menjëherë mbajtësve të kuotave;
b) ndërpritet vlerësimi dhe përcaktimi i çmimit për kuotat;
c) Fondi nuk emeton më kuota;
d) nuk mund të kryhet asnjë ndryshim në regjistrin e kuotave;
e) Fondi investimit nuk ushtrojnë asnjë veprimtari me përjashtim së veprimtarisë së mbylljes;
f) detyrimet dhe përgjegjësitë e Shoqërisë Administruese vijojnë të zbatohen deri në përfundim të mbylljes.

14. PËRLLOGARITJET DHE FREKUENCA E VLERËSIMIT TË ASETEVE, VLERËS NETO TË ASETEVE DHE ÇMIMIT

Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve të Fondit bazohet në ligjin nr. 56/20 , "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", rregulloren e miratuar me vendimin e bordit të si dhe parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Vlera e tregut e bonove dhe obligacioneve të Shtetit Shqiptar do llogariten duke përdorur vlerën e drejtë. Në kushtet e një tregu jo-aktiv të letrave me vlerë, rivlerësimi bëhet duke u mbështetur në yield-in deri në maturim, i cili llogaritet me metodën e interpolimit linear sipas yield-eve më të fundit të ankandeve të bonove të thesarit apo obligacioneve dhe ditëve të mbetura deri në maturim të letrës me vlerë.

Vlera neto e Fondit është vlera e aseteve minus detyrimet e tij. Ndër detyrimet kryesore renditet tarifa e administrimit e Shoqërisë Administruese. Vlera neto për kuotë apo çmimi i një kuote llogaritet duke pjesëtuar vlera neto të aseteve të Fondit me numrin e kuotave të Fondit.

Vlera neto e aseteve të Fondit dhe çmimi i një kuote do të llogaritet çdo ditë deri në orën 16:00 të asaj dite. Depozitari kuadron me Shoqërinë Administruese vlerën neto të aseteve. Dita e vlerësimit të aseteve të Fondit (t-1) do të jetë një ditë para ditës (t) gjatë së cilës është llogaritur vlera neto e aseteve për kuotë.

15. PUBLIKIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMIMI I INVESTITORËV

Shoqëria Administruese do të publikojë vlerën (çmimin) e kuotës në Fond dhe Vlerën Neto të Aseteve (VNA), çdo ditë në faqen e saj të internetit ëëë.albsiginvest.com. Çdo anëtar në Fond do të ketë akses në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese, përmes username dhe passëord, me të cilët kontrollon llogarinë në Fond.

Ndryshimet thelbësore të Prospektit duhet t'i komunikohen investitorëve dhe të publikohen në një gazetë të përditshme për një periudhë dy-mujore gjatë së cilës mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të kërkojnë nga Fondi shlyerjen e kuotave nëse ndryshimet thelbësore bien ndesh me pritshmëritë e tyre.

Shoqëria Administruese është e detyruar në mënyrë periodike të raportojë pranë AMF-së raporte mbi aktivitetin e saj sipas afateve të përcaktuara në Ligj.

Të gjitha raportet gjashtë-mujore dhe vjetore të Shoqërisë Administruese si dhe raportet e Fondit, Prospekti, rregullat e Fondit dhe çdo informacion shtesë do të vihet në dispozicion të investitorit pranë zyrave qendrore të Shoqërisë Administruese tek Rruga e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë pas një kërkese me shkrim apo nëpërmjet postës elektronike.

Prospekti i Fondit do jetë i disponueshëm në selinë e çdo agjenti të Shoqërisë (adresa e agjentëve ndodhet në faqen e internetit të shoqërisë në seksionit Shërbime/Rrjeti i Agjentëve).

Investitorët duhet të njoftojnë Shoqërinë Administruese nëpërmjet postës elektronike për çdo ndryshim të të dhënave të tij të kontaktit dhe të dhënave personale si: adresa, nr. tel, mbiemri (duke vendosur ID-në e re), shtetësia etj.

16. TRAJTIMI FISKAL I FONDIT DHE INVESTITORIT

Fondi për qëllime tatimi konsiderohet si pronar i titujve ose i të gjitha aseteve. Trajtimi tatimor i Fondit bazohet në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Të ardhurat që rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në Fond, do të tatohen, sipas Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Zbritja mbahen në burim nga fitimet kapitale nga investimi.

Trajtimi tatimor pasqyron trajtimin aktual të Fondeve të Investimit. Megjithatë si rezultat i ndryshimeve ligjore apo akteve nënligjore në të ardhmen vlerësimi fiskal i investitorit mund të ndryshojë.

17. TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

17.1. Tarifa e hyrjes dhe largimit:

Fondi NUK do t'i ngarkojë mbajtësit e kuotave me tarifë hyrëse apo tarifë largimi nga Fondi Kostot e komunikimit të ndryshimeve në Prospekt dhe komunikimet e tjera me investitorin;

17.2. Tarifa vjetore e administrimit:

Tarifa e kostos së administrimit të Fondit do të mbahet nga vlera neto e aseteve të Fondit. Ajo do të jetë 1% (një përqind) në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.

Tarifa e administrimit do të llogaritet në fund të çdo ditë dhe do të mbahet në ditën e fundit të çdo muaji si shumë e të gjitha vlerave ditore të muajit përkatës

Formula e llogaritjes ditore të tarifës së administrimit është: Tarifa vjetore e raportuar e administrimit X 1/365.

17.3. Tarifa të tjera:

Fondi do t'i ngarkojë mbajtësit e kuotave me kosto të tjera si më poshtë:

1. Tarifa që i paguhet Bankës Depozitare;
2. Kostot e auditimit vjetor të Fondit;
3. Tarifat dhe kostot që i paguhen AMF-së për Fondin;
4. Kostot dhe komisione për shit-blerje të aseteve të Fondit;
5. Kosto vërtetimesh të posaçme.

Tarifa e kostos së administrimit dhe kostot e tjera si më sipër listuar, në një vit financiar nuk do të tejkalojnë maksimumin prej 1.5% (një pikë pesë përqind) të vlerës neto të aseteve të Fondit.

Shoqëria Administruese mund të ndryshojë tarifat e Fondit në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij. Çdo ndryshim tarifash do të reflektohet në ndryshime në Prospektin e Fondit, i cili miratohet paraprakisht nga AMF-ja dhe i njoftohet mbajtësve të kuotave menjëherë.

18. DEPOZITARI

Shoqëria Administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e depozitarit për Fondin e Investimit me Bankën Tirana Sh.a regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT: J61924008V, me seli në Tiranë në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", që vepron si bankë me Licensën nr.07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu në bazë të vendimit Nr.23, datë 24.03.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licensuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për Fondin e Investimit me Vendimin Nr. 2 datë 06.06.2019 (pa afat).

Asetet e Fondit ruhen dhe mbahen nga depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren për kryerjen e transaksioneve për llogari të Depozitarit,

apo për qëllime të tjera përveç atyre të shprehura në këtë prospekt. Asetet e fondit nuk përfshihen në asetet e Depozitarit, në procedurat e likuidimit ose falimentimit të nisura sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj depozitarit.

Depozitari njofton menjëherë Autoritetin nëse ka arsye se Shoqëria Administruese ka shkelur ligjin ose prospektin dhe rregullat e Fondit.

1. Garanton, që shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave të realizuara për llogari të Fondit të investimit të Shoqërisë Administruese, janë kryer në përputhje me ligjin dhe rregullat e Fondit;
2. Riblen, shlyen kuotat dhe bën pagesa në favor të mbajtësve të kuotave në Fondin e investimit nga asetet e Fondit;
3. Garanton që llogaritja e vlerës neto të aseteve të aksioneve ose të kuotave në Fond është shpallur në përputhje me ligjin, rregulloret përkatëse të AMF-së, Prospektin dhe rregullat e Fondit;
4. Zbaton urdhrat e Shoqërisë Administruese për transaksionet, që përfshijnë titujt dhe asetet e tjera që përbëjnë portofolin, me kusht që ato të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj, me rregulloret e AMF-së, Prospektin dhe/ose rregullat e Fondit dhe bën të mundur realizimin dhe kryerjen e transaksioneve me titujt, që do të thotë se detyrimet monetare janë arkëtuar brenda kufijve kohorë, ligjorë ose kufijve kohorë të miratuar nga palët;
5. I raporton Shoqërisë Administruese për veprimet e shoqërisë për asetet e Fondit, të cilat i ruan në formë të shkruar ose elektronike dhe, në vijim, zbaton urdhrat e saj;
6. Arkëton të ardhurat dhe përfitimet e tjera përkatëse në dobi të Fondit dhe që u bashkëngjiten aseteve të tij;
7. Siguron se fitimi i Fondit përdoret në përputhje me këtë ligj, me Prospektin dhe/ose rregullat e Fondit dhe se të gjitha kostot e paguara nga Fondi janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në Prospekt dhe/ose rregullat e Fondit;
8. Kryen veprimtari të tjera profesionale ose administrative, sipas parashikimeve në kontratën ndërmjet tij dhe Shoqërisë Administruese ose këshillit të administrimit;
9. Mban, për çdo Fond të veçantë, evidenca dhe regjistrime për kryerjen e veprimtarisë si depozitar dhe i rakordon këto të dhëna me të dhënat e evidencave dhe të regjistrimeve të Shoqërisë Administruese;
10. I raporton AMF-së për çdo shkelje të këtij ligji dhe të kontratës nga Shoqëria Administruese, në rast se kjo shoqëri refuzon të pranojë kërkesën e tij për ndërprerjen e kësaj shkeljeje; U siguron akses në të dhënat dhe llogaritë kontabël, që lidhen me Fondin dhe asetet e tij, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe personave të tjerë të autorizuar për kontroll, përfshirë dhe AMF-në;
11. Me kërkesë të AMF-së, siguron çdo lloj informacioni për asetet, që mban për një sipërmarrje kolektive investimi, përfshirë, por pa u kufizuar, të dhëna, që provojnë ekzistencën e aseteve.

Depozitari nuk kryen asnjë veprimtari lidhur me Fondin të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi, me përjashtim të rastit kur depozitari ka bërë një

ndarje funksionale të kryerjeve të këtyre detyrave nga detyrat e tjera të Depozitarit, dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet në mënyrë të përshtatshme.

Depozitari nuk zotëron licensën si Shoqëri Administruese.

Depozitari zbaton politika dhe procedura për të administruar konfliktin e interesit me persona apo subjekte të lidhur të cilat garantojnë: a) identifikimin e konfliktit të interesit, b) ndërmarrjen e masave për të shmangur këto konflikte interesi.

Shoqëria Administruese dhe Depozitari raportojnë dhe monitorojnë konflikte interesi të cilat nuk mund të shmangen.

19. EMRI DHE SELIA E AUDITUESIT TË JASHTËM

Audituesi i jashtëm i Shoqërisë Administruese dhe i Fondit të Pensionit nën administrim është:

NEXIA AL Shpk, i regjistruar me vendim nr. 110, datë 06.11.2006, në Regjistrin Publik të IEKA. Me seli në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Pall. 29/1, kati 3, Apt. 6, Tiranë, Shqipëri
NIPT: K91721010Q
Web: https://www.nexia.al
Tel: +355 4 223 2726

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

20. VITI FINANCIAR

Viti financiar i Fondit do të jetë viti kalendarik 1 Janar - 31 Dhjetor.

21. INFORMACIONI PLOTËSUES

Secili investitor potencial duhet të verifikojë pranë zyrave qendrore të Albsig Invest Sh.a, Rruga e Barrikadave, Albsig HQ, 1001, Tiranë dhe pranë çdo agjenti, nëse ky Prospekt është versioni më i fundit dhe se nuk po kryhen ndryshime apo rishikime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

21.1. Etika dhe konflikti i interesit

Shoqëria Administruese ka ndërtuar Kodin e Etikës duke përdorur standardet e mirëqeverisjes dhe praktikave më të mira. Ky Kod adreson në mënyrë të drejtpërdrejtë konfliktin e interesit, i cili ndalon punonjësit e Shoqërisë Administruese të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal që bie ndesh apo kufizon ato në marrjen e vendimeve të duhura për Fondin.
Kujdesi

Fondi do të menaxhohet me profesionalizëm dhe integritet. Shoqëria Administruese preferon që Menaxherët e Portofolit të kenë certifikatën e njohur CFA (Chartered Financial Analyst) të cilët edukohen me standardet më të lartë të profesionalizmit dhe të etikës në industrinë financiare. Drejtori i Investimeve të Shoqërisë Administruese zotëron certifikatën CFA. Një nga standardet kryesore

është se Menaxheri i Portofolit duhet të tregohet i arsyeshëm, i matur dhe i mençur gjatë aktivitetit të investimit të Fondit.

21.2. Statusi FATCA

Për të qenë në përputhje me legjislacionin fiskal të kërkuar nga SHBA, Fondi do të regjistrohet në Agjencinë Amerikane të të Ardhurave (IRS: US Internal Revenue Service), konkretisht në FATCA (Foreign Account Tax Compliance Act). Bazuar në kërkesën e investitorëve, Shoqëria Administruese do të njoftojë këta të fundit për numrin unik (GIIN) për qëllime raportimi në FATCA.

21.3. Ankesat

Për çdo ankesë ju lutem dërgojeni me shkrim në adresën e Shoqërisë Administruese, tek Rruga e Barrikadave, Albsig HQ, 1001, Tiranë, Shqipëri
Të gjitha ankesat do të shqyrtohen dhe do t'u jepet përgjigje brenda 2 javëve nga data e pranimit të tyre.

21.4. Shkëmbimi Automatik i informacionit të llogarive financiare

Të gjithë investitorëve që duan të hapin një llogari të re, do ju kërkohet të plotësojnë një formë Vetëdeklarimi me të dhënat e tyre personale dhe tatimore në zbatim të Ligjit nr. 4 datë 30.01.2020 "Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare". Sipas këtij ligji, institucioneve financiare si Albsig Invest sh.a u kërkohet të raportojnë llogaritë financiare të klientëve të cilët janë rezidentë për qëllime tatimore në një juridiksion pjesëmarrës në Standardin e Përbashkët të Raportimit të vendosur nga OECD.

21.5. Egzekutimi Optimal i transaksioneve në tregun e kapitaleve

Shoqëria Administruese zbaton parimin e kërkimit të aplikimit të kostove minimale për egzekutimin e transaksioneve në tregun e kapitalit të shtjelluar në një politikë të posaçme mbi egzekutimin e transaksioneve.
Mbasi Shoqëiria ka përcaktuar llojin e letrës me vlerë në përputhje me politikën e investimit që duhet tregtuar për një fond të caktuar ajo zbaton disa kritere bazë për përzgjedhjen e ofertave më të mira.
Kriteret e përzgjedhjes së transaksionit më optimal janë:
1)Çmimi i letrës me vlerë
2)Kostot eksplicite
3)Kostot implicite
4)Kostot oportune të mos-ekzekutimit në kohë të një transaksioni

Egzekutimi i urdhërit realizohet për ato oferta që përbëjnë kombinimin më optimal të kritereve të lartëpërmëndura.

Përzgjedhja e ndërmjetësve tregtar të cilëve ju përcillen urdhërat kryhet në varësi të: a)reputacionit të ndërmjetësit,b)mbulimit të sektorëve të tregut të kapitalit që këto ndërmjetës janë të specializuar; c)volumet e tregtuara, d)shpejtësia e egzekutimit;e)platformat e përdorura.
Tregu i letrave me vlerë të emetura nga Republika e Shqipërisë përbëhet nga tregu primar dhe tregu sekondar. Në tregun sekondar transaksionet kryhen me ndërmjetës financiar të liçensuar sipas ligjeve dhe rregulloreve përkatëse. Tregu

i këtyre letrave është treg i rregulluar nga organet rregullatore si Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare.

ANEKSI 1: RREGULLAT E FONDIT ALBSIG STANDARD

Neni 1
Objekti i rregullave të Fondit

1. Rregullat e Fondit rregullojnë kushtet e veprimtarisë së Fondit të Investimit ALBSIG STANDARD (në vijim referuar si "Fondi", një sipërmarrje investimesh kolektive me oferte publike e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur, i themeluar nga Albsig Invest - Shoqëri Administruese e Fondeve te Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, si dhe marrëdhëniet ligjore ndërmjet Albsig Invest Sh.a (në vijim "Shoqëria Administruese") si dhe kuota mbajtësve në Fond (ne vijim referuar si "Investitorët").
2. Rregullat e fondit nuk përmbajnë detyrimisht të gjithë informacionin dhe të dhënat të paraqitur në Prospekt. Investitorët këshillohen të studiojnë të gjithë përmbajtjen e Prospektit.

Neni 2
Struktura juridike e Fondit

1. Fondi Albsig Standard është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, e veçantë dhe me pjesëmarrje të hapur.
2. Fondi nuk ka personaliteti juridik. Shoqëria administruese Albsig Invest sh.a është subjekti juridik që administron fondin Albsig Standard dhe e përfaqëson atë në ndaj palëve të treta.

Neni 3
Shoqëria Administruese

1. Shoqëria administruese e Fondit është Albsig Invest.
2. Albsig Invest Sh.a është një shoqëri aksionare, e krijuar në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në regjistrin tregtar me NIPT: L92208025J, e licensuar nga AMF për të vepruar si Shoqëri Administruese e Fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e Fondeve të Pensionit Vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, me seli në adresën: Rruga e Barrikadave, Albsig HQ, Tiranë, Shqipëri.
3. Aksionari i vetëm i Shoqërisë Administruese është "Albsig Jetë" Sh.a, e cila zotëron 100% të aksioneve. "Fondi i Investimit Albsig Standard" nuk mbështetet apo garantohet në çfarëdo lloj forme nga "Albsig Jetë" Sh.a, dhe rreziku i investimit i përket tërësisht investitorit.
4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 54,000,000 (pesëdhjetë e katër milionë) lekë.
5. Emri ligjor i shoqërisë është: Albsig Invest Sh.a - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.
6. Albsig Invest Sh.a ka si objekt të aktivitetit të saj:

a) Mbledhjen, investimin dhe kryerjen e pagesave për pension të fondeve të pensioneve, në përputhje me dispozitat e ligjore, si dhe bazuar në licensën nr. 5, datë 22.11.2019, të miratuar me vendimin nr. 210 nga AMF;
b) Krijimin dhe administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive në përputhje me dispozitat e ligjore, si dhe bazuar në licensën nr. 5, datë 22.11.2019, të miratuar me vendimin nr. 210 nga AMF.

7. Shoqëria Administruese gjatë aktivitetit të saj udhëhiqet nga parimet e qeverisjes së mirë, prioriteti i interesit të klientëve, integritetit, profesionalizmit, ligjet dhe rregulloret që bien mbi të.
8. Albsig Invest Sh.a. administron Fondet e mëposhtme:
   a) Fondi i Pensionit Vullnetar Albsig (Ref. FP 4) miratuar nga AMF me vendimin nr. 210, datë 22.11.2019.
   b) Fondi i Investimit Albsig Standard (Kodi F1-B5) miratuar nga AMF me vendimin nr. 255, datë 30/12/2019.

Neni 4
Krijimi dhe kohëzgjatja e Fondit

1. Fondi është krijuar për një afat të pacaktuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij me 1 Shkurt 2020.
2. Prospekti i Fondit është miratuar nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese si dhe është rimiratuar nga AMF me vendimin nr. _____, datë ___/___/2020.

Neni 5
Monedha bazë e Fondit

Monedha bazë e Fondit është "Lekë" e cila nënkupton se çdo blerje dhe shlyerje e kuotave do kryhet në monedhën Lekë.

Neni 6
Objekti i veprimtarisë së Fondit

Objekti i veprimtarisë së Fondit është grumbullimi i aseteve monetare ose të ngjashme nëpërmjet ofertës publike të kuotave në Fond, të cilat investohen sipas parimit të diversifikimit të rreziqeve në përputhje me Prospektin dhe investitorët kanë të drejtën të marrin pjesë proporcionalisht në fitimet e fondit, si dhe të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre, sipas dispozitave te Ligjit nr. 56/2020, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" (ne vijim "Ligji") si dhe Prospektit.

Neni 7
Pjesëmarrja në Fond

1. Çdo person mund të blejë kuota në Fond, duke hyrë në një marrëdhënie ligjore, me Shoqërinë Administruese.
2. Shoqëria Administruese llogarit dhe publikon çdo ditë vlerën e kuotës. Llogaritja e vlerës neto të aseteve dhe çmimit të kuotës i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga Depozitari, i cili është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes.

3. Çdo investitor nënshkruan formularin standard të aplikimit, duke konfirmuar se është njohur dhe ka rënë dakord me kushtet e përcaktuara në Prospektin e Fondit si dhe Rregullat e Fondit.

Neni 8
Investimi i aseteve

1. Asetet e Fondit do të investohen kryesisht në letra me vlere te emetuara dhe garantuara nga Qeveria e RSH, në përputhje me politiken e investimit të përcaktuar në Prospekt.
2. Në Fond mund të investojnë investitorë individualë dhe investitorë institucional (kompanitë e sigurimit, fondet e pensionit, etj). Kohëzgjatja e rekomanduar e qëndrimit në Fond është të paktën 2 vjet. Fondi është një alternative shumë e mirë për klient konservator që kërkojnë fleksibilitet të lartë mbi kursimet e tyre.
3. Objektivi i investimit të Fondit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe likuiditetin.
4. Kohëzgjatja mesatare e portofolit nuk duhet të kalojë vlerën prej 5 viteve.

Neni 9
Investimi minimal

Shuma minimale e investimit fillestarë është 50,000 Lekë dhe minimumi i investimeve në vazhdim është 20,000Lekë.

Neni 10
Të drejtat dhe përgjegjësitë e investitorëve në Fond

1. Investitorët në Fond kanë të drejtat e mëposhtme:
   a) Të kenë pronësinë e kuotave dhe të pajisen me certifikatën e pronësisë;
   b) Mund të tërheqin fitimin nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave;
   c) Të marrin pjesë në fitimet e Fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
   d) Të informohen periodikisht (raporte vjetore, gjashte mujore, etj.) ;
   e) Të kërkojnë shitjen e pjesshme apo të plote të kuotave në çdo kohë;
   f) Të kërkojnë transferimin në një tjetër sipërmarrje investimesh kolektive;
   g) Në rast falimenti të shoqërisë administruese, asetet e tyre të jenë objekt i së drejtës së veçimit.
2. Investitorët janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes se tyre në Fond.

Neni 11
Lloji i kuotave të Fondit

1. Kuotat e Fondit janë kuota akumulimi. Kuotat e akumulimit ri-investojnë të ardhurat nga investimit në mënyrë automatike dhe përfitimet për investitorët vijnë nëpërmjet rritjes së vlerës së kuotave.

2. Shoqëria Administruese bën të mundur që pasqyrat financiare të kontrollohen nga ekspertet kontabël të autorizuar të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 12
Shlyerja e kuotave

1. Investitorët kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shlyerjen e kuotave të tyre.
2. Investitorët plotësojnë një kërkese për shlyerje të kuotave në Fond.
3. Shlyerja e kuotave në Fond bëhet me çmimin e zbatueshëm në datën e mbërritjes së kërkesës se vlefshme për shlyerje në Shoqërinë Administruese, jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga dita e mbërritjes së kërkesës.

Neni 13
Depozitari

1. Shoqëria Administruese ka lidhur një kontratë me Banka Tirana Sh.a, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT J61924008V, me seli në Tiranë në adresën Rr. "Ibrahim Rugova", që vepron si bankë me Licencën nr. 07, datë 12.09.1996 të lëshuar nga Banka e Shqipërisë, e cila në përputhje me ligjin nr. 56/2020, "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", do të ofrojë shërbimet e Depozitarit për asetet e Fondit.
2. Pjesë përbërëse e rregullave të fondit është Deklarata e Kujdestarisë e Depozitarit.

Neni 14
Kontabiliteti

1. Shoqëria Administruese përgatit pasqyrat financiare dhe raportet e tjera financiare në përputhje me legjislacionin dhe standardet e pranuara të SNRF.
2. Viti financiare për Fondin do jetë viti kalendarik nga 1 Janar deri më 31 Dhjetor.

Neni 15
Trajtimi fiskal i Fondit

1. Fondi për qëllime tatimi konsiderohet si pronar i titujve ose i të gjitha aseteve. Trajtimi tatimor i Fondit bazohet në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Të ardhurat që rezultojnë nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave në Fond, do të tatohen, sipas Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Zbritja mbahen në burim nga fitimet kapitale nga investimi që realizohet në momentin e shlyerjes së kuotave.

Neni 16
Auditimi

1. Shoqëria Administruese bën të mundur që pasqyrat financiare të kontrollohen nga ekspertet kontabël të autorizuar të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
2. Audituesi i jashtëm i Fondit është Nexia AL.

Neni 17
Ruajtja e konfidencialitetit

1. Shoqëria Administruese dhe çdo punonjës trajton informacionin e klientit si shumë konfidenciale.
2. Të gjithë personat, qofshin punonjës të Shoqërisë, punonjës të Depozitarit, apo palëve të treta, janë përgjegjës për pasojat që rrjedhin direkt nga veprimet e tyre dhe që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e informacionit konfidenciale.
3. Albsig Invest sh.a është e detyruar të raportojë këtë lloj informacioni vetëm me kërkesë të organeve/institucioneve që e kanë këtë të drejtë në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 18
Detyrimet e Shoqërisë Administruese

Shoqëria Administruese gjatë administrimit të fondit ka detyrimet e mëposhtme :

a) të administroje Fondin në përputhje me objektivat e investimit të parashikuara në Prospekt;
b) të blejë asetet, në emër dhe për llogari të Fondit, duke i depozituar ato të një depozitar i vetëm;
c) të organizoje shitjen e kuotave të Fondit sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Prospekt;
d) të shlyejë në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme të gjitha detyrimet monetare;
e) të informoje periodikisht investitorët;
f) të garantoje ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave nën administrim.

Neni 19
Tarifat e Shoqërisë Administruese

1. Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifën a administrimit, e cila do të jetë deri në 1% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit;
2. Shoqëria administruese nuk do të aplikojë ndonjë komision hyrje ose daljeje nga fondi;
3. Komisione të tjera përveç tarifës së administrimit që do ti ngarkohen fondit janë: komisionet e transaksioneve me letrat me vlerë, shpenzimet për auditimin e fondit, tarifa e AMF, tarifa e depozitarit.
4. Të gjitha kostot që do i ngarkohen fondit nuk do kalojnë pragun prej 1.5% në vit.
5. Kostot që do i ngarkohen mbajtësve të kuotave personalisht janë: kostot e lëshimit të certifikatave të transaksionit ose vërtetime mbi pronësinë e kuotave, tarifat e transferimit, kostot e shpërndarjes së raporteve sipas kërkesës së investitorit.

6. Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese, do t'u njoftohet investitorëve të paktën 2 muaj përpara, sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe prospektin e Fondit.

Neni 20
Miratimi dhe ndryshimi i Rregullave të Fondit

1. Rregullat e Fondit miratohen nga Këshilli i Administrimit të Shoqërisë Administruese.
2. Rregullat e Fondit i bashkëlidhen prospektit dhe përbejnë pjesë integrale të tij.
3. Ndryshimet dhe shtesat në rregullat e Fondit, do të miratohen nga Këshilli i Administrimit si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me dispozitat e Ligjit.

Neni 21
Dispozita të Fundit

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi apo interpretimi i këtyre rregullave, do të zgjidhet bazuar në legjislacionin shqiptar, ku kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë.
2. Rregullat e Fondit do të hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

ANEKSI 2: DEKLARATA E KUJDESTARISË

Bazuar në Ligjin nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive në cilësinë e Depozitarit të Fondit të Investimit "Albsig Standard",
Deklaroj:
Pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive, do të ruhet nga Depozitari për llogari të investitorëve, duke respektuar parimin e barazisë, në përputhje me numrin e kuotave që zotëron çdo investitor, ose në rastin kur ekzistojnë njëkohësisht si kuota të ardhurash, ashtu edhe kuota akumulimi, në përputhje me pjesën individuale në pasurinë e sipërmarrjes, e llogaritur në bazë të kuotave të zotëruara nga çdo investitor.
Shumat, që ndodhen në llogarinë e parave për t'u shpërndarë, mbahen nga Depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje.
Monedha bazë e Fondit është Lekë.
Viti Financiar i Fondit është viti kalendari 1 Janar deri më 31 Dhjetor.

Depozitari: BANKA TIRANA, SH.A

Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm

Eralda Tafaj
Drejtor i Operacioneve

Tiranë, ___/___/2020

ANEKSI 3: FORMULA TIP I BLERJES SË KUOTAVE NË FONDIN E INVESTIMIT "ALBSIG STANDARD"

INFORMACION I RËNDËSISHËM:

- Çdo investitor duhet të lexojë dhe të kuptoj Prospektin dhe Rregullat e Fondit përpara se të kryej investimin në Fondin Albsig Standard.
- Dokumentet e nevojshëm që duhet të paraqiten nga investitori janë: a) karta identitetit/pasaportë e vlefshme, b) numër telefoni, adresë emaili apo adresë vendbanimi.
- Investimi juaj do të konsiderohet i realizuar me mbërritjen e pagesës në llogarinë e Fondit pranë Bankën Depozitare, Banka Tirana me Nr. Llogarie: AL49 2061 1004 0000 1003 2129 9100.
- Investimi i klientit do konvertohet në kuota duke zbatuar çmimin e kuotës në datën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit pranë Bankës Depozitare. Çmimi përllogaritet në përputhje me Ligjin nr.56/2020, "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Anëtari i Fondit të Investimit
Emër Atësia Mbiemër_____
Nr. Dokumentit të identifikimit _____,
adresë_____,
Datë lindja: _____ Vendlindja_____
Tel./Mob._____ E-mail_____
Shuma e Kontributit Mujor_____
Mënyra e pagesës_____
Burimi i të Ardhurave_____

Adresa korrespondencës:
_____
Nr. i Pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj)
_____
Nr. i NIPTIT _____ vetëm për personat tregtar te regjistruar juridik apo person fizik.

Shuma e investuar _____ mënyra e pagesës _____
Burimi i të ardhurave
_____
I punësuar në: _____, Pozicioni i punës: _____

Mënyra e Investimit:
Pagesë e Menjëhershme,
Plan Investimi. Frekuenca e zgjedhur e pagesave: Mujore, Tremujor, Tjetër-Specifiko_____
Kohëzgjatja e parashikuar e investimit: _____

DEKLARATË E INVESTITORËIT:
Unë deklaroj, se kam marrë, kam lexuar dhe kuptuar si dhe kam rënë dakord me Prospektin, Rregullat e Fondit dhe Informacionin Kryesorë për Investitorin(KIID).

Deklaroj, se kam lexuar, kuptuar dhe plotësuar pyetësorin e riskut dhe jam njohur me profilin tim të riskut. Jam i vetëdijshëm që ky lloj investimi nuk është i garantuar. Nënshkrimi i kontratës së investimit nënkupton hyrjen në një marrëveshje ligjore me Albsig Invest sh.a. Ky investim është bërë vetëm sipas dëshirës dhe gjykimit tim, dhe se jam në dijeni dhe kam kuptuar të gjitha rreziqet e përfshira, tarifat që lidhen me blerjen dhe shitjen e kuotave në fondin Albsig Standard dhe me gjithë kushtet që shoqërojnë këtë marrëdhënie. Kuptoj se të dhënat e mia personale të dhëna në këtë kontratë apo në çdo formular tjetër të nënshkruar nga unë janë të dhëna të detyrueshme të cilat do të përpunohen nga Albsig Invest sh.a me standardet më të larta të sigurisë dhe konform parashikimeve ligjore në fuqi, vetëm për qëllimin e ofrimit të produkteve ose për të përmbushur një detyrim ligjor që Albsig Invest sh.a mund të ketë, bazuar në aktet ligjore dhe rregullative në Republikën e Shqipërisë. Kuptoj që është detyrim i imi ti përditësoj këto të dhëna, sa herë që do të ndryshohen. Deklaroj se jam njohur me faktin se kam të drejtë, që në çdo kohë, me anë të një kërkese paraprake me shkrim, t'i kërkoj Albsig Invest sh.a, që të korrigjoj, apo të fshijë të dhënat e mia personale.

PËPUNIMI I TË DHËNAVE PERSONALE:
Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë aplikim është i vërtetë dhe i saktë. Unë shpreh pëlqimin tim që Albsig Invest sh.a, të mund t'i përpunoj të dhënat e mia personale të plotësuar në kontratë apo formular vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit për ti cilin po aplikoj. Kuptoj se çdo e dhënë personale lidhur me personin tim do të trajtohej me një nivel sigurie të standardeve me të larta në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Deklaroj dhe jap miratimin tim për procedimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga ana e Albsig Invest sh.a, duke i transferuar këto të dhëna drejt palëve kontraktore të cilat mund të jenë në cilësinë e përpunuesit në kuadër, të çeljes, mirëmbajtjes dhe administrimit të llogarisë. Në këtë kuadër, jam njohur me faktin që të dhënat e mia personale i transferohen subjektit Banka Tirana sh.a në cilësinë e Depozitarit të fondit bazuar në ligjin nr. 56/2020, "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", subjektit Albsig sh.a në mënyrë që shoqëria të ushtrojë vigjilencën e duhur si edhe të zbatojë detyrimet e tjera që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave.
Autorizoj në mënyrë të shprehur Albsig Invest sh.a, që të ruajë të dhënat e mia personale për një afat deri në 11-vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes meje dhe shoqërisë. Jam njohur nga shoqëria me faktin që për çdo pyetje apo informacion lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave të mia personale kam të drejtë të dërgoj e-mail në adresën elektronike: info@albsiginvest.al. Gjithashtu në çdo kohë ruaj të drejtën për t'u ankuar tek "Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale", dhe ruaj të drejtën për t'u tërhequr nga dhënia e pëlqimit për përpunimin e të dhënave.

Miratim për përpunimin e të dhënave personale në rast ofertash promocionale: Jap miratimin tim të pakushtëzuar që Albsig Invest sh.a, të përdor të dhënat e mia personale për qëllimin e përftimit nga ana ime të ofertave promocionale, si pjesë e paketës së produkteve dhe shërbimeve që shoqëria ofron apo do të ofroj në të ardhmen, nëpërmjet një ose disa kanaleve të informimit. Në këtë kuadër autorizoj Albsig Invest sh.a, që duke respektuar standardet më të larta të sigurisë, si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi, të delegojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të mia personale, duke i transferuar këto të dhëna tek palë të specializuara për këtë qëllim. Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me të drejtën që në çdo kohë të kërkoj nga Shoqëria revokimin e këtij miratimi.

◯Unë pranoj
◯Unë nuk pranoj

Investitori
Për Albsig Invest
(Emër Mbiemër/firmë)
(Emër Mbiemër/firmë/vulë)

ALBSIG STANDARD

Adresa: Rr. e “Barrikadave”,
ALBSIG HQ, Kati 8,Tiranë, Albania
Email: info@albsiginvest.al
Mob: +355 69 60 9922

WWW.ALBSIGINVETS.AL